
Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport
-XIII- Nr. i prot. 110 Me
Br. prot. Dt. 05. 02. 2026
RAHOVEC - ORAHOVAC



RAPORTI JANAR - SHTATOR 2026

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Letërnjoftimi i shkurtër lidhur me Kulturën, Rinin dhe Sportin në Rahovec.

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës. Është ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte antike të trashëguara nga epokat e hershme ilire-romake, objekte të trashëgimisë arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/ arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm arkeologjik, shpella, trashëgimi arkitekturore dhe fetare. Në komunën e Rahovecit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, rinore e sportive, aktivitete muzikore, teatrale, bibliotekare, ekspozita, festivale e aktivitete të ndryshme kulturo. Aktivitete të ndryshme zhvillohen në qendrat kulturore në Rahovec, Krushë të Madhe, Hoçë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc e gjetkë. Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi", me degët në Krushë të Madhe, Ratkoc e Hoçë të Madhe, qendrat sportive në Rahovec, palestra "Mizahir Isma", terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, Dejnë dhe në disa lagje të qytetit, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e sportit e rekreacionit. Po ashtu, funksionojnë shoqëritë kulturore-artistike, grupet muzikore e artistike, shoqatat e ndryshme, një qendër rinore aktive, që zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore, rinore e sportive. Ndër aktivitetet kryesore kulturore e promovuese që organizohen në komunën e Rahovecit janë; festivali i folklorit "Anadrinia Jehon" festa e Vjeljes së rrushit "Hardh Fest", "Agrofesta", Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, si dhe aktivitete të ndryshme periodike kulturore, rinore, sportive e promovuese.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xërxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën "Sulejman Krasniqi' në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc dhe Hoçë të Madhe.
- Kompleksin sportiv në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën sportive "Mizahir Isma".

Përveq buxhetit të caktuar komunal, drejtoria ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në shtator të vitit 2026. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

Aktivitete e muajit janar

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Vizita në objektet që janë në kuadër të drejtorisë.
- Formimi i keshillit organizues për aktivitetin përkujtimor "Flaka e Janarit".
- Takim njoftues me klubet sportive si dhe shoqëritë kulturore – artistike që veprojnë në Komunën e Rahovecit.
- Takim njoftues me të gjithë operatorët e projekteve që operojnë në DKRS.
- Homazhe përkujtimore për nder të "Flaka e Janarit" në Celinë, Krushë të Madhe, Nagavc dhe Hoqë të Vogël dhe tek vendi i rënjes në Brestoc. Manifestimi përkujtimor është përmbyllur me ceremoninë përkujtimore në Qendrën Kulturore "Mensur Zyberaj",.
- DKRS në bashkëpunim me shoqatën e pedagogëve të kulturës fizike ka mbajtur garën shkollore në futboll të vogël, basketboll dhe volejboll.

- **Shoqata e pedagogëve të kulturës fizike të Komunës së Rahovecit** në bashkëpunim me Drejtorinë për kulturë, rini dhe sport, organizuan garat komunale në futboll të vogël, basketboll dhe volejboll me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë.
- Pjesëmarrje në Akademinë Përkujtimore për Prof. Dr Sabahajdin Cena, në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, për nder të 3 vjetorit të vdekjes së tij,
- Vendim per ndalimin e pirjes se duhanit ne palestren sportive dhe objektet e hapura dhe të mbyllura sportive publike në Komunën e Rahovecit
- Për nder të manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor "Flaka e Janarit", Komuna e Rahovecit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall konkurs për art letrar, pamor dhe film dokumentar me metrazh të shkurtër.
- Manifestimi Flaka e Janarit, ku janë bërë homazhe te vendi i të rënëve si dhe manifestimin kulturor artistik, ku janë përzgjedhur fituesit e konkursit të artit letrar dhe është mbajtur pikë artistike nga Shkolla e Muzikës "Faik Sylka" dhe SH.K.A Bajram Curri.

Aktivitetet e muajit shkurt

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Për nder të 17 Shkurtit Ditës së Pavarësisë së Kosovës është formuar këshilli organizues lidhur me zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të kësaj dite
- Në qendrën e kulturës "Mensur Zyberaj", është bërë promovimi i librit i një autoreje antare e OJQ "FARDI".
- Me datë 05.03.2025 është publikuar thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve, klubeve sportive, shoqërive kulturo-artistike etj., të komunës sonë.
- Me datë 12.02.2025 kanë filluar aktivitetet sportive në Volejboll, sipas agjendës së këshillit organizues për nder të 17 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.
- Kanë përfunduar me sukses aktivitetet e parapara për nder të 17 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
- Janë mbajtur homazhe në nderim të heronjëve dhe dëshmorëve të kombit tek varrezat e dëshmorëve në Rahovec.
- Është organizuar aktivitete kulturore, përkujtimore e sportive në këtë organizim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Aktivitetet përkujtimore, kulturore e sportive në kuadër të shënimit të 17-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës u permbyllën me koncertin me nxënësit e shkollës së muzikës "Faik Sylka".

Janë mbajtur takim me të rinjët e Komunës së Rahovecit në Qendrën Rinore "SHL-Kosova", në takim është diskutuar për qështje të ndryshme, si aktivitetet e përbashkëta, trajnimet, debatet e aktivitetet të lira për të rinjët e Rahovecit. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka si mision fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje te të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale tek të rinjtë.

Aktivitete në muajin mars

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

Në bashkëpunim me OVL-UÇK-në janë mbajtur aktivitetet e 5, 6 dhe 7 Marsit – Epopeja e UÇK-së.

Kemi mbajtur takim me përfaqësuesit e OVL-UÇK-së, për organizimin e aktiviteteve përkujtimore që fillojnë nga data 25 mars, ku dhe është bërë agjenda për homazhe nga data 25 Mars – 02 Prill 2025.

Vizita në të gjitha vendpunimet ku janë duke u kryer punët të cilat janë në kuadër të DKRS-së.

- Në bibliotekën komunale "Sylejman Krasniqi" është mbajtur aktivitet për ditën botrore të Poezisë, aktiviteti u mbajt në bashkëpunim me klubin letrare "Xhevdet Bajraj".
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bëri thirrje të gjithve, Klubeve, Shoqatave sportive të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushat sportive, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që do të kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit dhe organizimin rinor gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Rini dhe Sport, në Komunën e Rahovecit.
- Me datë 05.03.2025 është publikuar thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve, klubeve sportive, shoqërive kulturo-artistike etj., të komunës sonë.
- Takim, me grupin punues rreth hartimit të planit për Trashegimi Kulturore.
- 07.03.2026, me rastin 7 marsit "Dita e Mësuesit", në qendrën e kulturës "Mensur Zyberaj", drejtori komunale e Arsimit ka mbajtur program.
- 07.03.2026, Aktivitet në bibliotekën "Sylejman Krasniqi" me klubin letrar "Xhevdet Bajraj".
- 24.03.206, Shfaqje teatrale në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj", në bashkëpunim me Edronia Art prokusion nga Shkupi, shfaqja është mbajtur me disa nga shkollat fillore të Rahovecit.
- 25.3.2026, nj epjes e stafit e angazhuar me zërim, në ditët purkujtimore për të rënët në fshatin Fortes dhe Celin.

- 27.03.2026, Aktivitet në qendrën e kulturës "Mensur Zyberaj", aktivitetti i realizuar nga nxënësit eshkollës profesionale "Selajdin Mullabazi".
- 30.03.2026, tubim përkujtimor në fshatin Opterush, një pjes e stafit e angazhuar me zërim.
- 30.03.2026, po ashtu produksioni Edronia Art, nga Shkupi, ka mbajtur shfaqje me nxënsë të shkollës fillore në shtëpin e kulturës në fshatin Xërxe.
- 02.04.2026, tubim përkujtimor në fshatin Hoqë e Vogël, stafi ka qenë i angazhuar me zërim.
- Gjatë kësaj periudhe është bërë përmbyllja e raportit të përformancës së drejtorisë për vitin 2025.

Aktivitetet gjatë muajit Prill

02.04.2026, tubim përkujtimor në fshatin Hoqë e Vogël, një pjesë e stafit ka qenë e angazhuar me zërim.

Datë, 18, prilli, shënimi i Ditës ndërkombëtare të monumenteve dhe vendbanimeve historike, aktiviteti është realiziuar në bashkëpunim me drejtorinë komunale të Arsimit, me ç'rast nxënësit e disa prej shkollave fillore të komunës sonë kanë vizituar muze, si dhe objekte të rëndësisë historike dhe kulturore të komunës sonë.

Datë 24, prill, në kuadër te planifikimit të aktiviteteve drejtoria, ka shënuar Ditën ndërkombëtare të librit, aktiviteti është ndihmuar dhe nga klubi letrar "Xhevdet Bajraj", aktiviteti është mbajtur në bibliotekën komunale "Sylejman Krasniqi".

Datë, 26, prill, aktivitet kushtuar 28 vjetorit të daljes publike të UCK- së, në fshatin Drenoc, në aktivitet drejtoria e kulturës ka qenë e angazhuar që pjesa e programit kulturor të jetë sa më i pasur për nderë të asaj dite, andaj drejtoria ka angazhuar Sh.K.A "Bajram Curri" nga Krusha e Madhe më qrastë programi është përcjellur me këng dhe valle të folklorit tonë.

Po ashtu gjatë muajit maj, 2026, në kuadër të javës së Dëshnorëve të komunës së Rahovecit, drejtoria ka mbështetur me stafë si dhe logjistik në realizimin e aktiviteteve të shumta që janë mbajtur në nderim të të rënëve për liri.

16 maj, 2026, në Muzeun Ukshin Hoti, në Krushë të Madhe, është shënuar dita e zhdukjes së atdhetarit Ukshin Hoti, prandaj dhe drejtoria kështë angazhuar që aktiviteti të jetë sa më i fuqishëm.

28 maj, shënimi i ditës së Qendrës Kulturore "Mensur Zyberaj", datë kjo mjaft e rëndësishme për komunën tonë, andaj kjo dat është shënuar me aktivitete përkujtimore si dhe me program të pasur artistik të realizuar nga Sh.K.A "Bajram Curri", nga Krusha e Madhe.

Dita ndërkombëtare të monumenteve dhe vendbanimeve historike - Aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit,, me ç'rast nxënësit e disa shkollave fillore kanë vizituar muzetë dhe objekte të rëndësisë historike e kulturore të komunës së Rahovecit.

Dita ndërkombëtare e librit – Në bashkëpunim me Klubin letrar „Xhevdet Bajraj" është mbajtur aktivitet kulturor e promovues për librin dhe lexueshmërinë e të rinjve. Aktiviteti është është mbajtur në bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi".

Publikimi i përfituesve të subvencioneve për OJQ në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit.

Takim me Shoqatën e Çiklistëve Kokrrat, lidhur me aktivitetin e tyre për mbjelljen e drunjtëve dekorues në qytet për nder të ditës së tokës.

Në bashkëpunim me DKA, për nder të ditës ndërkombëtare të monumenteve kulturore, për nxënësit e SHFMU Isa Boletini, Bekim Sylka dhe Sadedin Hajda kemi oranizur vizitë edukuese dhe promovuese të monumenteve në komunën tonë, si Kulla e Toni e Micit në Opterushë, Muzeun e Masakrës, Muzeun e Ukshin Hotit, Muzeun Etnografik, Kompleksin Memorial në Gradish dhe Sahat Kullën.

Takim me Sadik Krasniqin, lidhur me kërkesën e tij për ndërtimin e një muzeu. Poashtu është diskutuar për aktivitetet për trashëgiminë kulturore në Rahovec, dhe promovimin e saj.

Pjesëmarrje në Konferencën "DREAMin Kosovo 2025 & LEAPin Conference" në Parkun ITP në Prizren. Në konferencë morën pjesë edhe të rinjtë vullnetarë nga SHL-Kosova.

Ka mbaruar plotësimi dhe dorëzimi i të dhënave për objektet sportive dhe rinore në komunën tonë. Procesi i plotësimit ka qenë online.

Mbjellja e drunjtëve dekorativ për nder të Ditës së Tokës, bashkë me Shoqatën e Çiklistëve Kokrrat. Drunjtë janë mbjellë në Sheshin e Qytetit, në Shkollat Bekim Sylka, Sadedin Hajda, Qerdhja Tulipanë dhe në ambiente të rrugëve.

Vizitë në punimet në objektin e Qendrës Rinore dhe Kulturore. Është dorëzuar Situacioni i 15 i punëve të kryera. Dosja është dorëzuar në MKRS për pagesë ndaj operatorit.

Janë nënshkruar kontratat me OJQ përfituese të subvencione në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit. Gjithsej kanë përfituar 34 OJQ me vlerë prej 243000 Euro, rritje prej 9% krahasuar me vitin 2025.

Takim me disa studentë të Fakultetit të Mjekësisë. Kanë kërkuar zgjatjen e orarit të punës në Bibliotekë. Është marrë vendim që orari të zgjatet, me orar nga ora 08:00 deri në ora 20:00 ditëve të punës, dhe nga ora 08:00 deri në ora 12:00 gjatë vikendeve.

Takim me Shoqatën e Peshkatarëve AMUR, kanë kërkuar nga Komuna që ti japim leje, që në vendin ku ata kryejnë aktivitetet e tyre të peshkimit, të bëjnë pastrimin dhe rregullimin e vendit, pra në Lumin Drin në Krushë të Madhe.

Takim me Kryetarin e Federates se Futbollit – Regjioni i Gjakoves Agim Nura, kemi marre konfirmim qe do te mbështetemi me rregullimin e fushës ne Ratkoc njëherë, vetëm se duhet te verifikojmë disa procedura para se te bëjmë marrëveshjen per fillimin e rregullimit te stadiumit. Poashtu, do te shikohet

qe ne nje te ardhme te afërt nëse mund te sigurohet tepihu artificial per nje stadium me te vogël per shkollat e futbollit. Dhe, mund te shikohet qe te na ndihmojnë te rregullojmë zhveshtoret ne Xerxe, pasi qe per momentin fusha eshte e shfrytëzueshme edhe me bari natyral.

Festivali Folklorik "Anadrinia Jehon" Edicioni i 25 u zhvillua për tre net rresht. Kanë marrë pjesë gjithsej 17 grupe nga vende të ndryshme të trevave shqiptare. Janë ndarë gjithsej 17 çmime për grupet pjesëmarrësve.

Simpoziumi Ndërkombëtar i Arteve Edicioni i 25 u mbajt në shtëpinë e artistëve u zhvillua për tre ditë rresht. Morën pjesë 36 artistë nga vende të ndryshme të trevave shqiptare.

Takim me Departamentin për Trashëgimi Kulturore në Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit

Takim në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore, janë diskutuar kompetencat e komunës dhe bashkëpunimi me QKRT për objektet e mbrojtura në Rahovec

Është përfunduar plani për trashëgimi kulturore, është dorëzuar për publikim

Pjesëmarrje në ekspozitën për Trashëgimi Kulturore Historike të Komunës së Rahovecit

Pjesëmarrje në promovimin e shtatë veprave të Hysen Berishës, të cilat edhe janë mbështetur financiarisht nga Komuna e Rahovecit

Shënimi i Ditës Botërore të Fëmijëve, aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me shoqatën e gruas "Hareja", vendi i mbajtjës qendra e kulturës "Mensur Zyberaj".

Aktivitet në shtëpinë-muze të heroit Skënder Rexhepi në Mrasor, që shënon ditëlindjen e heroit.

Aktivitet në kompleksin memorial në Gradish në shënim të ditës së çlirimit të komunës së Rahovecit.

Aktivitet, koncert festiv me rastin e shënimit të ditës së Çlirimit të komunës së Rahovecit.

Aktivitet kulturor në muzeun "Ukshin Hoti", Krushë e Madhe. Dita e zhdukjes së Ukshin Hotit

Aktivitetet gjatë muajit Korrik

Me datë 09.07.2026 nga MKRS-ja kanë qenë në vizitë në objektin e Qendrës për Kulturë dhe Inovacion.

Në Celinë, Malësi të Vogë dhe Gexhe është rregulluar ndriçimi në fushën sportive.

Është kompletuar dokumentacioni për rregullimin e fushave sportive në Sapniq dhe Pataqan të Poshtëm.

Është shënuar Epopeja e Rahovecit, ku janë mbajtur aktivitete të ndryshme përkujtimore në nderim të saj.

Aktivitetet kulturore për nder të Muajit të mërgimtarëve, janë mbajtur aktivitetete të shumta në nderim të pritjes së tyre.

U mbajt turneu tradicional në futboll "Dëshmorët dhe Martirët e Fortesës" në Fortesë.

U mbajt turneu në futboll "Ratkoci nderon dëshmorët" në Ratkoc.

Plotësimi i dokumentacioni për rregullimin e fushave sportive në Sapniq dhe Pataqan të Poshtëm.

Është funksionalizuar fusha e tenisit, ku edhe është riaktivizuar edhe klubi i tenisit Rahoveci

Aktivitetet gjatë muajit Gusht

Punimet në Kompleksin sportiv – janë kryer: kubëzat, kabinat, kabinat e kamerave, parkingu pothuajse u kry, ka mbetur vetëm tribunat dhe gomat rreth fushës.

Gushti shënon organizimin e festivalit tradicional FARDI FEST, ku DKRS respektivisht sektori i Rinisë dhe Sportit ka qenë i përfshirë në shumë aktivitete.

Janë mbajtur gara të ndryshme sportive dhe lojëra tradicionale në Kompleksin përkujtimor të dëshmorëve në Gradish.

DKRS ka qenë e përfshirë edhe në përgatitjet për shënimin e festës së vjeljes së rrushit HARDH FEST, duke ofruar mbështetjen e nevojshme për organizimin sa më të mirë të kësaj feste.

Homazhe në nderim të dëshmorëve Skender Kastrati në Malësi të Vogël dhe Sabri Morina në Vrajakë.

Promovimi i librit "Në rrugën e lirisë" nga autori Hazir Luta, monografi kushtuar jetës dhe veprës së dëshmorit Skender Kastrati.

Pjesëmarrje në Festivalin e Kostumeve të Kulturës Arbëreshe, me ç 'rast është nënshkruar edhe Deklarata e Miqësisë ndërmjet komunës së Rahovecit dhe Vaccarizze Albanese.

Është organizuar aktiviteti "Ora e Pritjes" në bashkëpunim me platformën Liria ka Emër, ku në sheshin e qytetit është vendosur ekran i orës së pritjes në nderim të çlirimtarëve tanë që ndodhen në Hagë. Ekrani do të qëndrojë deri në ditën e gjykimit të tyre më 16.09.2026.

Aktivitetet gjatë muajit Shtator

Aktivitetet kulturore gjatë festivalit Hardhfest, si Hardhbike (shëtitja me biçikletë ne rrugët e vreshtave), përzgjedhja e mbretëreshës së rrushit, si dhe Ora letrare "Xhevdet Bajraj".

Homazhe në nderim të dëshmorëve në Zatriq, Mazllum Kastrati, Xhafer Vehapi dhe Esat Kastrati.

Takim me kryetarin e Federatës se Hendbollit te Kosovës dhe Komesarin e Garave.

Kemi shënuar ditën ndërkombëtare të tokës, bashkë me të rinjtë e SHL Kosova, kemi dalë në pastrimin e vendit afër stacionit të autobusëve.

Organizimin e protestës "Jo në emrin tim" në mbështetje të krerëve të UÇK-së.

BIBLOTEKA KOMUNALE "SULEJMAN KRASNIQI" - RAHOVEC

Sektori i huazimit të librit

Janë regjistruar: 339 Anëtar .

Me pagesë 339. Falas 0.

Të rinjë: Meshkuj 129. Femra 169.

Të rritur: Meshkuj 12. Femra 29.

Nxënës 297. Student 21. Punëtor 4. Bujq 2. Amvise 2. Të tjerë 13.

Libra të lexuara: Janë bërë 2193 shërbime me libra.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar: 123 lexues.

Sektori i përpunimit të librit

Pasurimi i fondit librar: 170 ekzemplarë.

Dhuratë nga autorë: OVL- Organizata e luftes së UÇK-së Komuna Rahovec 38 ekz., Mustaf Krasniqi 6 ekz., Ilirjana Gashi 7 ekz., Valbona Hoti 15 ekz, SHB "Dukagjini" 10 ekz., Ediona Morina 5 ekz., Bekim Aliu 2 ekz., Bedri Zyberaj 3 ekz., Ramadan Deliu 1 ekz., Qemajl Krasniqi 3 ekz., Sumeja B.Hoti 10 ekz., Fatime Kalimashi 2 ekz., Mustafë Kryeiu 4 ekzemplarë, Ismail Dushi: Heshtja flet 1 ekzemplarë, Xhemile Hoxha – Aliu: Antigona emblema e lirisë 1 ezemplarë, Izet Shala: Mëkatet mbesin mëkate 1 ekzemplarë, Revistë Shqiptare: Albania Shqipëri Natyrale 2 revista, Hysen Berisha 7 ekzemplarë, Biblioteka Prizren 46 ekzemplarë, Xhemajli Shala 7 ekzemplarë, Biblioteka "Hajdin Berisha"-Suharekë 1 ekz. **Fondi total i librave në biblioteka** 29322 ekzemplarë.

Anëtarësia dhe libra të lexuara

Janar-Shtator	Anëtar të regjistruar	Të rinjë		Të rritur		Me pagesë	Falas	Lib.të lexuara
		Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra			
Rahovec	297	116	146	11	24	297	1701	297
Krushë	21	7	13	0	1	21	322	21
Ratkoc	21	6	10	1	4	21	170	21
Gjithsej	339	129	169	12	29	339	2193	339

Përbërja sociale e lexuesve

Janar-Shtator	Nxënës	Studentë	Punëtor	Bujq	Amvise	Të tjerë	Gjithsej
Rahovec	262	21	4	0	1	9	297
Krushë e Madhe	20	0	0	0	1	0	21
Ratkoc	15	0	0	2	0	4	21
Gjithsej	297	21	4	2	2	13	339

Salla e leximit - Pasurimi i fondit librar - Fondi librar në biblioteka

Janar - Shtator	Salla e leximit	Pasurimi i fondit librar	Fondi librar në biblioteka
Rahovec	79	146	22900
Krushë e Madhe	32	12	4570
Ratkoc	12	12	1852
Gjithsej	123	170	29322

Aktivitete Janar

Me datë: 14.01.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë OVL-Organizata e Veteranëve të luftes së UÇK-së Komuna Rahovec për dhurimin e librave të autorit Prof.dr. Sabahajdin Cena të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

Proza popullore legjendare shqiptare 10 ekzemplarë.

Kronikë nëpër stuhi I 6 ekzemplarë.

Kronik nëpër stuhi III 11 ekzemplarë.

Kronikë nëpër stuhi IV 11 ekzemplarë.

Në Krushë të madhe i kemi dorëzu 12 ekzemplarë, dhe në Ratkoc 12 ekzemplarë.

Me datë: 16.01.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autorin Mustaf Krasniqi për dhurimin e librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

Gjurmët e një meditimi 3 ekzemplarë.

Në djepin e fjalës 3 ekzemplarë.

Me datë 16.01.2025 Udhëheqësja e bibliotekës "Hajdin Berisha" Suharekë Arbrnitë Hoxha Ramaj bashkë me stafin vizituan bibliliotekën tonë, gjatë takimit biseduam për bashkëpunime dhe aktivitete.

Me datë: 20.01.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autoren Ilirjana Gashi për dhurimin e librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

100 rrugët e dashurisë 7 ekzemplarë.

Me datë 27.01.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autoren Valbona Hoti për dhurimin e librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

Unë jam forca 8 ekzemplarë.

Vargjet e mia flasin 7 ekzemplarë.

Aktivitete Shkurt

Me datë: 09.02.2026 Në ambientet e Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi", nga shtëpia botuese "Dukagjini" u organizua promovim i lektyrave për fëmijë nga autorë të ndryshëm për nxënësit e klasave të parë deri në klasën e pestë. Në këtë aktivitet u përfshinë rreth njëqind fëmijë të ciklit të ulët shkollor, nën

përcjelljen e mësueseve të tyre. Nxënësit u shpërblyen me nga një dhuratë nga organizatori. Shtëpia botuese "Dukagjini" pasuroi edhe bibliotekën tonë me dhjetë (10) ekz.

Me datë: 13.02.2026 Kemi marrë pjesë në shtëpinë e kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec ku u promovua libri i parë me poezi "Brenda botës sime" i autores më të re Ediona Morina, nxënëse e klasës së shtatë në SHFMU "4 Dëshmorët", Ratkoc. Autorja dhuroi pesë (5) ekz. për bibliotekën "Sulejman Krasniqi", Rahovec, urojmë suksese të vazhdueshme në rrugëtimin e saj letrar.

Me datë: 13-17.02.2026 Kemi marrë pjesë në aktivitete për Ditën e Pavarësisë së Kosovës

Aktivitete Mars

Me datë: 02.03.2026 Autori Bekim Aliu pasuroi bibliotekën tonë me dy (2) ekzemplrë.

Titulii i librit: Fadil Vokrri legjenda që nuk shuhet kurrë

Me datë: 24.02 deri me 02.03.2026 Në bashkëpunim me Shërbimin Sprovues të Kosovës - Zyra Rajonale në Gjakovë Departamentin për të mitur kemi patur dy të mitur që i është shqiptuar masa e diversitetit për kryerjen e orëve të punës pa pagesë në dobi të përgjithshme. Lloji i punës: Pastrim dhe mirëmbajtje në bibliotekë dhe muze, si dhe punë të tjera që i përshtaten moshës dhe aftësive të miturit.

Me datë: 06.03.2026 Në bibliotekën Komunale Sulejman Krasniqi në Rahovec shënohet 66 vjetori i lindjes së poetit Xhevdet Bajraj, u interpretuan poezi të poetit dhe krijime autorialetë të pranishmeve. Organizimi i orës poetike u bë nga Klubi Letrar Xhevdet Bajraj.

Me këtë rast autori Bedri Zyberaj dhuroi tre (3) libra dhe e pasuroi bibliotekën tonë.

Titulli i librit: Vetëm me vetminë

Me datë: 30.03.2026 Autori Ramadan Deli pasuroi bibliotekën tonë me një (1) ekzemplarë.

Titulli i librit: Rahoveci vitet e terrorit serb dhe rezistenca ndaj tij

Aktivitete Prill

Me datë 02.04.2026 Nxënësit e shkollave fillore në nder të 2 prillit – Ditës Ndërkombëtare të librit për fëmijë, realizuan një vizitë shumë të veçantë në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi". Në këtë ditë të rëndësishme për librin dhe leximin, fëmijët patën mundësinë të njihen më afër me botën e librave. Gjatë vizitës së tyre në bibliotekë, nxënësit u njohën nga afër me hapësirat e leximit, rregullat e shfrytëzimit të bibliotekës dhe fondin e librave për fëmijë. Ata patën mundësi të qëndrojnë në këndin e leximit, të shfletojnë libra të ndryshëm dhe të bisedojnë për rëndësinë që ka leximi në zhvillimin e tyre. I falënderojmë nxënësit si dhe mësueset për bashkëpunimin dhe përkushtimin e tyre në kultivimin e dashurisë për librin tek fëmijët.

Faleminderit të gjitha shkollave për vizitën.

Me datë:15.04.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autorin Qemajl Krasniqin, për dhurimin e tre (3) librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

Dashuri e gurtë 3 ekzemplarë.

Me datë: 16.04.2026 Fëmijët parafillorë të shkollës "Isa Boletini" vizituan bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" me edukatoren e tyre Merita Ejupi, fëmijët patën mundësi të shikojnë librat dhe ambientin e leximit.

Me datë: 17.04.2026 Degën e Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi" në Ratkoc e vizituan fëmijët e Qerdhes së bashku me edukatoret e tyre Arbenita Hoti dhe Fatjona Himaj. Ata patën rastin të njihen me librat dhe komentojnë tregimin e tyre.

Me datë: 17.04.2026 Fëmijët e grupit parashkollor A2 të shkollës "Isa Boletini" vizituan bibliotekën komunale" Sulejman Krasniqi" me edukatoren e tyre Anisa Korenica. Fëmijët patën mundësi të shikojnë libra të ndryshëm, për çfarë shërben biblioteka dhe si duhet të merren dhe të kthehen librat në gjendje të rregullt.

Me datë: 23.04.2026 Në ditën botërore të librit degën e bibliotekës "Sulejman Krasniqi" në Ratkoc e vizituan nxënësit parashkollor "Katër Dëshmorët" me edukatoren e tyre Liridona Halilaj, nxënësit e klasës së parë (1) me mësuesen Diana Bytyqi, dhe nxënësit e klasës së Katërt (4) me mësuesen Elvie Morina, si dhe nxënësit e klasave të treta (3) me mësueset e tyre Emine Morina, Nasibe Morina dhe Zejnie Krasniqi të shkollës fillore "Katër Dëshmorët" në Ratkoc. Nxënësit gjatë qëndrimit të tyre në bibliotekë, patën rastin të njihen me hapsirat, fondin librar dhe rëndësinë e leximit në zhvillimin e tyre personal dhe arsimor.

Me datë: 23.04.2026 Në ditën botërore të librit fëmijët vijues të Harejës bashë me edukatoret e tyre vizituam bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi" dhe muzeun e qytetit "Ali Hasku". Gjatë kësaj vizite, nxënësit u njohën me ambientet e bibliotekës, mënyrën e organizimit të librave si dhe me vlerat historike e kulturore që ofron muzeu. Kjo përvojë ishte shumë e dobishme dhe motivuese, duke i nxitur nxënësit të zhvillojnë dashurinë për librin, dijen dhe trashëgiminë kulturore.

Me datë: 24.04.2026 Kemi marë pjesë në shënimin e 20 vjetorin e themelimit të Këndit Amerikan në Prizren. Ku në një atmosferë të këndshme u shënua ky jubile i rëndësishëm.

Me datë: 28.04.2026 Në hapsirat e bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi" u mbajtë promovimi i librit "Edhe malet flasin" të autores Sumeja B.Hoti. Autores i urojmë suksese të mëtejshme në rrugëtimin e saj letrar, dhe presim edhe shumë libra nga ajo. E falënderojmë shumë autoren për dhurimin e dhjetë (10) librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

Edhe malet flasin 10 ekzemplarë.

Gjatë muajit Prill me libra i kemi pasuruar këto biblioteka shkollore:

Shfmu "Vëllezërit Frashëri", Drenoc 30 libra.

Shfmu "Sulejman Vokshi", Polluzhë 25 libra.

Shfmu "Rilindja", Çifllak 25 libra.

Shfmu "Rudolf Walther", Dejnë 26 libra.

Shfmu "Katër Dëshmorët", Ratkoc 41 libra.

Shfmu "Dëshmorët e lirisë", Pataqan i ulët 25 libra.

Shfmu "Sakip Bellaqa", Pataqan i epërm 26 libra.

Shfmu "Sapniqi", Sapniq 25 libra.

Shfmu "Hamëz Thaqi", Xërxe 34 libra.

Shfmu "Liria", Fortesë 26 libra.

Aktivitete Maj

Me datë: 06.05.2026 Në kuadër të planprogramit nga lënda e Gjuhës Shqipe nxënësit e klasave të gjashta të shfmu "Bekim Sylka" me mësimdhënëset e tyre vizituan bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi".Gjatë vizitës, ata u njohën me hapësirat e bibliotekës, librat dhe rëndësinë që ka leximi në zhvillimin e dijes.

Me datë: 08.05.2026 Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 8 Majit – Ditës së Monumenteve Kulturore, nxënësit e klasëve të VI-ta Shfmu "Gëzm Hamza-Piktori" zhvilluan një vizitë edukative në muzeun e qytetit "Ali Hasku".

Vizita kishte për qëllim njohjen e nxënësve me vlerat historike dhe trashëgiminë kulturore të vendit tonë, duke pasuruar njohuritë e tyre përmes një përvoje të drejtpërdrejtë mësimore.

Me datë: 15.05.2026 Fondit të bibliotekës sonë iu shtuan edhe dy libra të rinj, dhuruar nga shkrimtarja Fatime Kalimashi me titullin:

Fatimja pjesa e I

Fatimja pjesa e II

Me datë: 18.05.2026 Për nder të ditës Ndëkombëtare të muzeve. Nxënesit e Shfmu Isa Boletini bashkë me mësusesin e vizituan muezun "Ali Hasku". Gjatë kësaj dite të veçantë, nxënësit patën mundësinë të njihen më nga afër me historinë, trashëgiminë kulturore dhe vlerat e komunës tonë.

Aktivitete Qershor

Me datë: 10.06.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autorin Mustaf Kryeziu për dhurimin e librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

"The exodus '99" 2 ekzemplarë.

Kujtesa dëshmon 2 ekzemplarë.

Me datë: 22.06.2026 Klubi Letrar "Xhevdet Bajraj" ka zhvilluar një vizitë në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi", duke e pasuruar fondin e saj me tre (3) ekzemplarë librash dhe (2) revista.

Ismail Dushi: Heshtja flet 1 ekzemplarë.

Xhemile Hoxha – Aliu: Antigona emblema e lirisë 1 ezemplarë.

Izet Shala: Mëkatet mbesin mëkate 1 ekzemplarë.

Revistë Shqiptare: Albania Shqipëri Natyrale 2 revista.

Ky aktivitet ndihmon në rritjen e bashkëpunimit kulturor dhe pasurimin e literaturës për lexuesit.

Gjatë muajit Qershor me libra i kemi pasuruar këto biblioteka shkollore:

Shfmu "Dëshmorët e Zatriqit" , Zatriq 25 libra.
Shfmu "Isa Boletini" Rahovec 64 libra.
Shfmu "Bekim Sylka" Rahovec 59 libra.
Shml "Xhelal Hajda" Rahovec 48 libra.
Shmlp "Selajdin Mullaabazi-Mici" Rahovec 48 libra.
Shfmu "Sadedin Hajda" Rahovec 40 libra.
Shfmu "Gëzim Hamza-Piktori" Rahovec 40 libra.

Shfmu "Heronjtë e Kosovës" Hoqë e Vogël 27 libra.
Shfmu "Faik Konica" Celinë 25 libra.
Shfmu "Nesimi Elshani" Nagavc 25 libra.
Shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe 40 libra.
Shfmu "Haki Stërmilli" Zoqishtë 28 libra
Shfmu "Lidhja e Prizrenit" Opterushë 25 libra

Aktivitete Korrik

Me datë: 01.07.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autorin Hysen Berisha për dhurimin e shtatë (7) titujve të ri të librave. Ky është një gjest shumë fisnik dhe një kontribut i çmuar për pasurimin e fondit librar në bibliotekën tonë. Dhurimi i librave ndihmon drejtpërdrejt në edukimin e brezave të rinj dhe u krijon mundësi më të mëdha lexuesve për të pasur qasje në tituj të ri.

Me datë: 14.07.2026 Në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit u zhvillua një takim pune me udhëheqësit e bibliotekave të Prizrenit, Suharekës, Malishevës, Dragashit dhe Rahovecit. Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje të shumta që ndërlidhen me fushën e bibliotekarisë, si dhe u planifikua realizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe edukative.

Një hap i rëndësishëm drejt bashkëpunimit është edhe pasurimi i fondit të librave për Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec. Biblioteka e Prizrenit ka dhuruar katërdhjetë e gjashtë (46) ekzemplarë librash, të cilët përbëjnë një vlerë të shtuar për të gjithë lexuesit, nxënësit dhe studentët, duke mundësuar atyre qasje më të gjerë në tituj të rinj të zhanreve të ndryshme, duke përfshirë romane, literaturë shkencore dhe lektyra shkollore.

Me datë: 23.07.2026 Falënderojmë autorin dhe poetin Xhemajli Shala për kontributin e çmuar Dhurimi i shtatë (7) titujve të rinj për Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec pasuron fondin e librit dhe nxit dashurinë për leximin.

Aktivitete Gusht

Me datë: 12.08.2026 Kemi marrë pjesë në bibliotekën e Prizrenit ku u mbajtë organizimi letrar „Në zemër të atëdheut, me fjalën e mërgimtarit" u lexuan punimet nga shkrimtar të shumtë mërgimtarë. Si dhe u bë promovimi i librit „Struktura e mendimit'' e autorit Bardhyl Halitjahaj.Nga ky vit u caktua takim tradicional në Prizren, takimi me poetët e mërgatës.

Me datë: 24.08.2026 Kemi marrë pjesë në kuadër të Ditës së Bibliotekës të Qytetit "Hajdin Berisha" në Suharekë. Po ashtu Biblioteka e Qytetit për herë të parë promovoi librin "Mozaik letrar". Ky libër është një përmbledhje e shkrimeve të krijuesve që morën pjesë në konkursin letrar.

Aktivitete Shtator

Me datë 14.09.2026 Kishim kënaqësi që në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" dega në Ratkoc erdhën në vizitë tre klasë të dyta të shkollës fillore "Katër Dësmorët"-Ratkoc bashkë me mësueset e tyre Anita Krasniqi-Hoti, Nasibe Morina dhe Mirlinda Hoti. Nxënësit ishin shumë kurreshtar të njiheshin me bibliotekën dhe shërbimet që i ofron biblioteka.

Me datë 28.09.2026 Kemi marrë pjesë në edicionin e 23-të i Javës së Bibliotekave, me temën "RILINDJA – Zëra në kujtesë", i cili kushtohet historisë së shtypit, librit dhe trashëgimisë së Rilindjes.

PALESTRA SPORTIVE "MIZAHIR ISMA"

Gjatë kësaj periudhe Janar-Shtator në palestrën sportive "Mizahir Isma" janë realizuar aktivitetet të shumta sportive, ndër aktivitetet janë:

JANAR 2026

KB Rahoveci 029 – KB Ylli (U18) | 10.01.2026 | 10:00

KB Rahoveci 029 – KB Kerasan | 10.01.2026 | 12:00

KB Rahoveci 029 – KB New Basket (U18) | 17.01.2026 | 11:00

KB Rahoveci 029 – Bora | 24.01.2026 | 18:45

SHL Kosova (Volejboll) | 25.01.2026 | 17:00

KB Rahoveci 029 – KB Bashkimi | 31.01.2026 | 11:00

SHKURT 2026

KV 17 Korriku – KV Feronikeli | 07.02.2026 | 18:00

KB Rahoveci – Trepça (U14) | 07.02.2026 | 10:00

KB Rahoveci 029 – KB Vllaznimi (U12) | 07.02.2026 | 11:30

KB Rahoveci 029 – KB Vllaznimi | 08.02.2026 | 19:30

Ndeshje për nder të 17 Shkurtit | 13.02.2026, aktivitet sportiv.

Futboll i vogël | 14.02.2026 | 10:00

KH Rahoveci – KH Prishtina | 14.02.2026 | 16:00 & 17:30

KV 17 Korriku – KV Forca | 15.02.2026 | 18:30

KB Rahoveci – Trepça (U18) | 15.02.2026 | 13:30

KH Rahoveci – KH Besa | 19.02.2026 | 18:30 & 20:00

KV 17 Korriku – KV Kaçaniku | 21.02.2026 | 19:30

KB Rahoveci – Junior 06 (U16) | 21.02.2026 | 14:00

KB Rahoveci – KB Bashkimi (U12) | 21.02.2026 | 10:30

KB Rahoveci 029 – KB Prishtina (U14) | 21.02.2026 | 12:30

FC Rahoveci – FC Shtimja | 22.02.2026 | 21:00

KH Rahoveci – KH Trepça | 28.02.2026 | 18:30 & 20:00

MARS 2026

Shoqata Pedagogëve– Futboll i vogël | 03.03.2026 | 11:00

KV 17 Korriku – KV Dukagjini | 05.03.2026 | 20:00

KB Rahoveci – KB Dardania (U12) | 07.03.2026 | 10:00

KB Rahoveci – KB Theranda (U16) | 07.03.2026 | 12:00

FC Rahoveci – FC Jetoni | 08.03.2026 | 21:00

KH Rahoveci – KH Llapi | 08.03.2026 | 15:00 & 17:00

KV 17 Korriku – KV Prishtina | 11.03.2026 | 20:00

Shoqata Pedagogëve - Futboll te vogel| 12.03.2026 | 12:00

KH Rahoveci – KH Vushtrria | 13.03.2026 | 18:30 & 20:00

Shoqata e Pedagogëve – Futboll i vogël | 13.03.2026 | 10:00

KB Rahoveci – KB Pressing (U18) | 14.03.2026 | 12:30

KB Rahoveci 029 – KB Borea (U12) | 14.03.2026 | 11:00

KB Rahoveci 029 –KB Peja | 21.03.2026 | 17:00

FC Rahoveci – FC Komorani | 22.03.2026 | 21:00

KV 17 Korriku – KV Libero | 22.03.2026 | 18:00

Gara shkolla fillore (Volejboll) | 24.03.2026 | 09:00

Gara shkolla të mesme (Volejboll) | 29.03.2026 | 09:30

KB Rahoveci 019 – KB Dardania (U16) | 29.03.2026 | 11:00

PRILL 2026

KB Rahoveci 029 – Trepça | 04.04.2026 | 17:00

KH Rahoveci – KH Vëllaznimi | 05.04.2026 | 16:00 – 18:00

KB Rahoveci – KB Peja | 09.04.2026 | 17:00

MAJ 2026

KH Rahoveci – KH Besa | 03.05.2026 | 18:00

FC Rahoveci – FC Rinia | 09.05.2026 | 20:30

FC Shtimja – FC Trepça | 15.05.2026 | 20:30

KH Rahoveci – KH Kastrioti | 23.05.2026 | 20:00

KH Besa – KH Vëllaznimi | 23.05.2026 | 11:00

KH Rahoveci – KH Deçani | 23.05.2026 | 13:00

KH Rahoveci – KH Kastrioti | 31.05.2026 | 20:00

Liga e Juniorëve – Java e Dytë

Data: 31.05.2026

Vendi: Palestra Sportive "Mizahir Isma", Rahovec

KH Rahoveci – KH Vëllaznimi | 11:00

KH Besa – KH Deçani | 13:00

QERSHOR 2026

KH Besa – KH Vëllaznimi | 13.06.2026 | 11:00

KH Rahoveci – KH Deçani | 13.06.2026 | 13:00

KORRIK 2026

KB Rahoiveci | Stërvitje me grupmosha të reja

KV 17 Korriku | Stërvitje e klubit te volejbollit me femra

GUSHT 2026

KB Rahoiveci | Stërvitje me grupmosha të reja

KV 17 Korriku | Stërvitje e klubit te volejbollit me femra

SHTATOR 2026

KB Rahoveci 029 – KB Bashkimi| 10.09.2026 | 19:00

KB Rahoveci 029 – KB Trepça | 19.09.2026 | 19:00

KB Rahoveci 029 – KB Bashkimi| 26.09.2026 | 17:00

KB Bashkimi – KB Trepça | 27.09.2026 | 19:00 (Superkupa e Kosovës)

Numri total i aktiviteteve të evidentuara: 58.

- Basketboll: 23 aktivitete
- Futboll: 3 aktivitete
- Futsal: 5 aktivitete
- Hendboll: 16 aktivitete
- Sport: 2 aktivitete
- Volejboll: 9 aktivitete

Gjatë muajve prill dhe maj 2026, në Palestrën Sportive "Mizahir Isma" janë zhvilluar me sukses aktivitete sportive nga sportet e basketbollit, hendbollit, futbollit të vogël dhe garat e ligave të grupmoshave të reja. Këto aktivitete kanë kontribuar në promovimin e sportit, angazhimin e të rinjve dhe zhvillimin e jetës sportive në komunën e Rahovecit.

PËRFUNDIMI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-shtator 2026 është angazhuar në aktivitete dhe punë të ndryshme si:

- → Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- → Vizitë objekteve sportive;
- → Takime me klube dhe shoqata sportive;
- → Vizitë objekteve kulturore;
- → Takim me rini dhe shoqata e organizata rinore;
- → Organizimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
- → Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga DKRS-ja;
- → Takime të rregullta në kuadër të DKRS-së;
- → Përgaditje të raporteve javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

- **Rahovec, tetor 2026**

Drejtor i DKRS-së

Atdhe Rama